




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

<i>Ekspteri shqyrtues i brendshëm:</i> <i>Ilir Halili:</i> 	<i>Data e autorizimit të ekspertit:</i> 11.01.2023	<i>Nr. i lëndës:</i> 28/23	<i>Data e dorëzimit të raportit:</i> 30.01.2023
--	--	----------------------------	--

1. BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datë: 10.01.2023, OE: “Cactus sh.a”, ka parashtruar ankesën me nr.28/23, kundër vendimit të AK-MPB, lidhur me aktivitetin e prokurimit me numër “214-22-13725-1-1-5” dhe me titull “Furnizim me licenca te Microsoft-it për IRK dhe Edukim”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë te negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, vlerë të madhe, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës për tri vite: 15,000,000.00€.

Datat për fazat e ndryshme të Aktivitetit të Prokurimit deri tek ankesa në OSHP janë si në vijim:

Data e njoftimit për përdorim të procedurës së negociuar: 30.11.2022

Afati i fundit për dorëzim të ofertave: 12.12.2022

Njoftimi mbi vendimin e AK-së : 29.12.2022

Kërkesa për rishqyrtim: 30.12.2022

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: 04.01.2023

Ankesa në OSHP: 10.01.2023

Konform nenit 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092 të LPP-së, eksperti shqyrtues i prokurimit i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Raporti i ekspertit shqyrtues te prokurimit, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Cactus” me nr. 28/23, kundër vendimit të AK-MPB, lidhur me aktivitetin e prokurimit me numër “214-22-13725-1-1-5” dhe me titull “Furnizim me licenca te Microsoft-it për IRK dhe Edukim”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

2.DISPOZITAT E SHKELURA NGA AK DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Historikisht ne te kaluaren Cactus sh.a. ishte perfitues i kontrates kornize "Furnizim me licenca Microsoft" dhe ato nr i kontrates 49/14 dhe me nr te prokurimit : 4. 202/17/080/111 dhe si te tille e konsiderojm se AK ka ber shkelje te neneve te artemperenduara duke mos lejuar konkurencen e lire dhe ne kete menyre duke demtuar buxhetin me ane te limitimit te konkurences dhe kontraktimit ne menyre te negociuar (me kontrate nje burimore).

Duke ditur se ne si Cactus si bashkepuntore i kompanise SoftëerONE e cila gezon te drejten globale per furnizime te tilla dhe e cila me email-in e adresuar institucionit tuaj ka shpreh interes qe te marr pjese ne kete procedure te prokurimit dhe ju si te tille nuk e keni marr parasysh, ne konsiderojme qe kompania jone Cactus sh.a dhe SoftëerOne jemi te demtuar e kete proces jo transparent te prokurimit dhe kerkojme nga ju qe kjo procedure ne teresi anulohet , kerkojme qe te shpallet si tender publik dhe te gjithë operatorët e autorizuar te kane te drejte te barabarte te konkurimit.Ne kete menyre garantohet konkurenca e lire, transparenca dhe nuk demtohet buxheti shtetëror.

7. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET ANKIMORE

Sipas nenit 35.2 të LPP, autoriteti kontraktues, pa ndonjë qëllim për të diskriminuar kundër apo në favor të ndonjë operatori ekonomik, ka përdorur Procedurën e Negociuar pa publikim të Njoftimit për Kontratë. Arsyeja për marrjen e këtij vendimi:

Neni 35.2.3(ii): të drejte ekskluzive për të ofruar shërbime të tilla

SHPJEGIM

Arsyetim për procedurë të negociuar për zhvillimin e aktivitetit të prokurimit " Furnizim me licenca te Microsoft-it për IRK dhe Edukim"

Kërkesa për zhvillimin e aktivitetit të prokurimit për " Furnizim me licenca te Microsoft-it për IRK dhe Edukim" nëpërmjet Procedurës së Negociuar pa Publikim të Njoftimit për Kontratë bazohet në rrethanat objektive të krijuara dhe të detyrueshme teknike për një kontratë të natyrës së tillë.

Rrethanat objektive dhe detyrimet teknike të krijuara

Dihet se Institucionet e Republikës së Kosovës që nga themelimi i tyre përdorin produktet dhe pakot softuerike të teknologjisë Microsoft në të gjitha nivelet, dhe në vazhdimësi përdorimi i këtyre produkteve është bazuar në marrëveshje (kontrata) për "licencim me shumicë" për një periudhë të caktuar kohore (3 vite) dhe të cilat janë të lidhura nëpërmjet procedurave të prokurimit.

Gjithmonë palë të marrëveshjes (kontratës) se tiftë kanë qenë ASHI (për qeverinë) dhe furnizuesve/partnerëve të autorizuar nga Microsoft, meqenëse Microsoft nuk lidh marrëveshje të tilla direkte me nivele qeveritare.

Që nga data 01.01.2021 e deri me tani ASHI është pa një kontratë valide me furnizues/partner të Microsoft rreth licencimit të të gjitha produkteve të Microsoft të cilat përdoren nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Mungesa e një kontrate të tillë ka krijuar një situatë të tillë në të cilën për rreth dy (2) vite institucionet e Republikës së Kosovës të shfrytëzojnë licencat e produkteve të Microsoft-it pa një kontratë valide lidhur me menaxhimin e kostos së shfrytëzimit të licencave dhe shërbimeve të Microsoft-it dhe ka krijuar një situatë të paqartë rreth obligimeve financiare të cilat qeveria e Republikës së Kosovës i detyrohet Microsoft-it për shfrytëzimin e licencave dhe shërbimeve. E gjithë kjo situatë është krijuar për pasojë të dështimit të aktivitetit të prokurimit "Furnizim me licencat të Microsoft-it për IRK dhe Edukim", aktiviteti i cili është iniciuar nëpërmjet procedurës së hapur të prokurimit në nëntor të vitit 2020 dhe është anuluar në muajin Prill të vitit 2022.

Duke ditur që ri-inicimi ose ri-tenderimi i këtij aktiviteti të prokurimit nëpërmjet procedurës së hapur të prokurimit, përsëri mund të prodhojë situatë të njëjta sikur të aktivitetit të anuluar dhe nuk siguron që institucionet e Republikës së Kosovës të lidhin një kontratë valide me furnizues/partner të Microsoft-it në një kohë sa më të shkurtër, atëherë për të mos e vështirësuar dhe komplikuar edhe me tej situatën e paqartë të krijuar, si njësi e kërkesës propozojmë që ri-tenderimi i këtij aktiviteti të bëhet nëpërmjet Procedurës së Negociuar pa Publikim të Njoftimit për Kontratë.

Gjithashtu, përveç situatës së krijuar përdorimi i Procedurës së Negociuar pa Publikim të Njoftimit për Kontratë propozohet edhe për faktin që aktualisht furnizues/partner të Microsoft të autorizuar për Republikën e Kosovës si Licensing Solution Provider (LSP) janë vetëm dy kompani, një me bazë në Shqipëri (InfoSoft Systems) dhe një me bazë në Serbi (Kontrejd Distribucija DOOEL). Konfirmimin për ekzistimin e vetëm të këtyre dy kompanive të autorizuar për Republikën e Kosovës e kemi direkt nga përfaqësues të Microsoft – konfirmim i cili është marrur nga komunikimet e fundit që kemi pasur. Duke pasur parasysh rrethanat e krijuar viteve të fundit në mes të dy shteteve Kosovë-Serbi, dhe duke marrë për bazë që OE përveç furnizimit me softuer të licencuar do ofroj edhe përkrahje teknike në zgjidhjen e problemeve e që për zgjidhjen e këtyre problemeve duhet edhe të ketë qasje në sisteme të rëndësishme (infrastrukturën kritike) shtetërore gjë që mund të rrezikojë sigurinë nacionale të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi, i rekomandojmë Divizionit të Prokurimit që për negociatë të ftohet InfoSoft Systems si furnizues/partner i Microsoft-it i autorizuar për Republikën e Kosovës si Licensing Solution Provider (LSP).

Për më shumë një kontratë e lidhur me furnizuesin e autorizuar apo partnerët e Microsoft me statusin "ofrues të zgjidhjeve për licencim" ("Licensing Solution provider") ka për qëllim kryesor menaxhimin e transaksioneve (Qeveri – Microsoft) lidhur me kostot e licencave për produktet e përdorura, përfshirë shërbimet e mbështetjes teknike dhe profesionale në kuadër të kontratës dhe nuk ka për qëllim kryesorë caktimin e çmimit të kontratës, meqenëse Microsoft nuk lidhë marrëveshje të tilla direkte me nivele qeveritare dhe për kontratë/marrëveshje të tilla për shfrytëzim të licencave Microsoft ka të vendosur apo caktuar paraprakisht tavane të çmimeve të cilat janë të njëjta për të gjithë furnizuesit/partnerët me statusin LSP.

Gjithashtu me përdorimin e Procedurës së Negociuar pa Publikim të Njoftimit për Kontratë, bazuar në përvojën e deritanishme me këtë lloj të kontratës dhe politikave të Microsoft, si njësi e kërkesës sigurojmë plotësisht që:

- ASHI do të ketë rol aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratës, veçanërisht sa ka të bëjë me çmimet, afatet e pranimit, kushtet, karakteristikat teknike dhe garancionet, dhe
- Çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi përkatës i tregut.

Pra, përveç detyrimit teknik që ka qeveria e Republikës së Kosovës që të vazhdojë përdorimin e produkteve të Microsoft, situatë objektivist e dukshme ashtu siç u përshkrua më lartë, dhe roli i furnizuesit/partnerit të Microsoft-it me statusin LSP, besojmë që përdorimi i Procedurës së Negociuar pa Publikim të Njoftimit për Kontratë është në përputhje të plotë me LPP Nenin 35, paragrafi 2.1 (i), dhe është me rëndësi për ASHI-në në aspektin e menaxhimit të kontratës me përzgjedhjen njërit nga dy furnizuesit/partnerët e autorizuar për produktet e Microsoft-it në Republikën e Kosovës.

Vlera e parashikuar për 36 muaj është 15,000,000.00 €.

Departamenti i Prokurimit në MPB-së ju njofton, se pa kurrfarë qëllimi që të diskriminojë kundër ose në favor të një operatori ekonomik do të përdorë Procedurën e Negociuar Pa Publikimin e Njoftimit për Kontratë në harmoni me Nenin 35 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe të negociojë me InfoSoft Systems.

8. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES (VENDIMI PËR RISHQYRTIM)

Përgjigje në pretendimin ankimor

AK, Ministria e Punëve të Brendshme, me kujdes i ka analizuar pretendimet e OE Cactus sh.a në Kërkesën për Rishqyrtim dhe konstaton se pretendimet e tij janë të pa bazuara, sepse nuk ka ofruar asnjë dëshmi të vlefshme, që i njëjti OE kualifikohet si "palë e interesuar," sikurse përkufizohet nën nenin 4 paragraf 1.26 të LPP-së.

Pretendimet e cekura në Kërkesën për Rishqyrtim nga Cactus sh.a. nuk qëndrojnë, për shkak se në asnjë dokument të bashkëngjitur nuk figuron se OE Ankues është i Autorizuar për shitjen e produkteve të Microsoft-it për territorin e Republikës së Kosovës, pjesë e këtij aktiviteti të prokurimit.

Ju sqarojmë se AK-MPB-ja, ka ftuar dhe përzgjedhur OE e shpallur fitues, pas komunikimeve me Kompaninë Microsoft dhe informatave-sqarimeve nga ta, se cilët OE janë të autorizuar për shitjen e licencave në territorin e Republikës së Kosovës pjesë e këtij aktiviteti të prokurimit, andaj AK-MPB ka vepruar në pajtueshmëri me Nenet 7 dhe 50 të LPP-së.

2

Konkluzion:

- I. REFUZOHEJ e pa bazuar Kërkesa për Rishqyrtim e tenderuesve Operatori Ekonomik, Cactus Sh.A., Prishtinë, Kosovë, kundër Njoftimit për dhënien e Kontratës të Autoritetit Kontraktues të publikuar në platformën elektronike e-prokurimi me datën 30/12/2022, për aktivitetin e prokurimit me Titull: "Furnizim me licenca të Microsoft-it për IRK dhe Edukim", me numër prokurimi: 214-22-13725-1-1-5,
- II. Mbetet në fuqi Njoftimit për dhënien e Kontratës i publikuar me 30/12/2022 i Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me aktivitetin e prokurimit për "Furnizim me licenca të Microsoft-it për IRK dhe Edukim", me numër prokurimi: 214-22-13725-1-1-5.

Ministria e Punëve të Brendshme nga provat e prezantuara me lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

9. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTIN

N/A

10. ARSYETIMI PËR DEVLJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

11. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE ANKIMORE

Pretendimi nr.1

Pretendimi kryesor (dhe i vetëm) sipas ankesës nr.28/23 është se :

"Ne si Cactus si bashkepunore i kompanise SoftëerONE e cila gezon te drejten globale per furnizime te tilla dhe e cila me email-in e adresuar institucionit tuaj ka shpreh interes

Raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Cactus" me nr. 28/23, kundër vendimit të AK-MPB, lidhur me aktivitetin e prokurimit me numër "214-22-13725-1-1-5" dhe me titull "Furnizim me licenca të Microsoft-it për IRK dhe Edukim", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

qe te marr pjese ne kete procedure te prokurimit dhe ju si te tille nuk e keni marr parasysh, ne konsiderojme qe kompania jone Cactus sh.a dhe SoftëerOne jemi te demtuar ne kete proces jo transparent te prokurimit dhe kerkojme nga ju qe kjo procedure ne teresi te anulohet , kerkojm qe te shpallet si tender publik dhe te gjithë operatorët e autorizuar te kane te drejte te barabarte te konkurimit.Ne kete menyre garantohet konkurenca e lire, transparenca dhe nuk demtohet buxheti shteteror.”

Pas analizimit të shkresave të lëndës, gjegjësisht përgjigjes së AK-së në kërkesë për rishqyrtim (të prezantuar në pikën 8 të këtij raporti), kemi gjetur se AK në arsyetim të refuzimit të kërkesës për rishqyrtim ka konstatuar se të njëjtit kanë pas komunikimeve me prodhuesin “Microsoft” dhe sqarimeve të marra nga ta se cilët janë OE të autorizuar për shitjen e këtyre produkteve në territorin e Republikës së Kosovës kanë vepruar në pajtim me nenin 7 dhe 50 të LPP-së.

AK-MPB po ashtu ka pohuar se “cactus” me asnjë shkresë nuk e ka dëshmuar se i njëjti është i autorizuar për shitjen e këtyre produkteve në territorin e Republikës së Kosovës dhe se i njëjti nuk kualifikohet si “palë e interesuar”.

Gjatë shqyrtimit të mëtutjeshëm të ankesës, me 20.01.2023 ne kemi kërkuar sqarime shtesë nga AK, konkretisht kemi kërkuar si dëshmi komunikimet e AK-së me “Microsoft”.

Ne kemi pranuar përgjigje nga AK-MPB, ku të njëjtit i kanë bashkangjitur edhe komunikimet me përfaqësues të Microsoft, konkretisht me “Alexander Rizov Account Executive Public Sector Bulgaria and Kosovo”.

Në këto komunikime z.Rizov ndër tjera pohon se “*partnerët e Microsoft me status LSP (Ofruesit e mëdhenj të zgjidhjeve).*

Ky është lloji i partnerëve që kualifikohen dhe autorizohen nga Microsoft për të ofruar produkte dhe shërbime sipas Marrëveshjes së Ndërmarrjes dhe Marrëveshjes së Abonimit të Ndërmarrjes.

Aktualisht Microsoft ka dy partnerë LSP të autorizuar për Republikën e Kosovës. Këta partnerë janë InfoSoft Systems shpk dhe Komtrejd Distribucija DOOEL Shkup”.

Në vazhdim, ne i jemi drejtuar direkt z.Rizov, duke kërkuar konfirmim se të njëjtit janë përgjegjës/autorizuar për territorin e Kosovës, si dhe kemi kërkuar konfirmim se vetëm këto dy kompani janë të përzgjedhura për të ofruar produktet e këtij prokurimi për institucionet e Republikës së Kosovës.

Me 26.01.2023 kemi pranuar përgjigje nga z.Rusov, i cili sa i përket pyetjes së parë pohon se :

“Përgjigje: Microsoft ka një strukturë të orientuar nga rajoni. Brenda kësaj strukture Kosova është pjesë e një rajoni të quajtur “Multi-Country” i cili është një filial në tregun e Evropës Qendrore dhe Lindore. I ashtuquajturi rajon me shumë vende (MC) përfshin 25 vende.

Udhëheqëse e rajonit MC është Michelle Simons e cila është menaxhere e përgjithshme për të 25 vendet, dhe unë jam pjesë e ekipit të saj në pozicionin e ekzekutivit të llogarisë përgjegjëse për klientët e qeverisë në Bullgari dhe Kosovë.

Konfirmoj se jam përgjegjës për komunikimin komercial nga ana e Microsoft-it dhe person kontaktues për pyetje në lidhje me institucionet qeveritare në Republikën e Kosovës.

Sa i përket pyetjes së dytë se a janë vetëm këty dy kompani “Infsoft Systems” dhe “Komtrejd distribucija dooel Skopje” të autorizuar për shitjen e këtyre produkteve, i njëjti është përgjigjur se :

“Përgjigje: Në cilësinë time të ekzekutivit të llogarisë në Microsoft, përgjegjës për institucionet qeveritare në Republikën e Kosovës, konfirmoj se aktualisht, Microsoft Partnerët “InfoSoft Systems shpk” dhe “Komtrejd Distribucija DOOEL Shkup”, janë dy LSP (ofruesit e zgjidhjeve të licencimit).) i autorizuar nga Microsoft për të ofruar produkte dhe shërbime sipas programeve të Marrëveshjes për Ndërmarrje të Microsoft dhe Marrëveshjes së Abonimit të Microsoft Enterprise në Republikën e Kosovës.”.

Bazuar në të dhënat e cekura më lart, konkretisht konfirmimit të Microsoft se për produktet e kërkuara në këtë prokurim për shitje Institucioneve të Republikës së Kosovës janë vetëm dy kompanitë e lartcekura, mendimi i ekspertit është se OE ankues “Cactus” nuk mund të jetë “palë e interesuar” në këtë procedurë, ashtu siq ka konstatuar edhe AK-MPB.

Mbi bazën e kësaj rekomandimi i ekspertit është që ankesa e OE ankues të hedhet si e palejuar.

Gjatë analizimit të provave në këtë procedurë, jemi vënë në dijeni se përveq “Infsoft Systems” i autorizuar është edhe “Komtrejd Distribucija DOOEL Shkup”.

Megjithëse kjo kompani zyret i ka në Republikën e Maqedonisë së Veriut në Shkup, e njëjta është pjesë e një korporate më të madhe “Comtrade Group”, e themeluar dhe me bazë në Serbi-Beograd.

Duke u nisur nga ky fakt, natyra e këtij prokurimi dhe niveli i qasjes që do ketë kompania e kontraktuar në këto sisteme/programe (ku sipas AK-MPB kompania do të ketë qasje në infarstrukturë kritike shtetërore), kujdesi/rreziku i mundshëm për siguri nacionale i shprehur nga AK-MPB mendojmë se është arsyeshëm për dërgimin e ftesës për ofertim vetëm kompanisë “Infsoft Systems”, megjithatë mendojmë se i mbetet panelit shqyrtues të vlerësoj vetë edhe një herë këtë çështje para marrjes së vendimit përfundimtar.

12. MENDIMI I EKSPERTËVE SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Duke u bazuar në të gjeturat, krahasimet, faktet, dokumentet e shqyrtuara dhe të cekura në këtë ekspertizë, eksperti shqyrtues i propozonë Panelit Shqyrtues të OSHP-së që ankesa e OE të hudhet si e palejuar, në të njëjtën kohë rekomandojmë që të mbetet në fuqi vendimi i AK-MPB.

Raporti i ekspertizës t’i dorëzohet:

- | | |
|---------------------------|---------------|
| - Autoritetit Kontraktues | - “MPB” |
| - Panelit Shqyrtues | - OSHP |
| - OE ankues | - OE “Cactus” |

Raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Cactus” me nr. 28/23, kundër vendimit të AK-MPB, lidhur me aktivitetin e prokurimit me numër “214-22-13725-1-1-5” dhe me titull “Furnizim me licenca të Microsoft-it për IRK dhe Edukim”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)